REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN**
**KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 129/3 prot.

Laç, më 26.01.2023

# VENDIM

**Nr. 07, datë 23/01/2023**

## "PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I KURBINIT"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nën pika 1.1, shkronja "b", nën pika 1.7, shkronja "a", nenit 54, shkronja "m" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të kërkesës së Komunitetit të Kurbinit nr. 6817 Prot. datë 19.12.2022, "Për dhënie titull qytetar nderi z. Boris Sandër Frrokaj"pas propozimit nga komisioni dhe Kryetaria e Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI;**

1. Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Kurbinit **z. Boris Sandër Frrokaj** me motivacion :

**"Për vlerat e larta sportive duke u shpallur Kampion Kombëtar në sportin e fortë të Mundjes. Shembull për rininë kurbinase"**

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

**>Prefektit Të Qarkut Lezhë**
**>Drejtoria e Arsimit Kultures Rinisë dhe Sporteve**
**>Arkivi**

**SEKRETARI I KESHILLIT**
**Arber LEKA**

**KRYETARE E KESHILLIT**
**Edlira LLESHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KURBIN

REPUBLIKA E SHQIPERISË

**BASHKIA KURBIN**
**KESHILLI BASHKIAK**

Laç, më 26.01.2023

Nr.______prot.

**VENDIM**

**Nr 08 Datë 23 / 01 / 2023**

**"Për nje ndryshim ne VKB nr. 106 datë21.12.2022 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023" per dhenie te nje shperblimi financiare (Honorar) nga fondi reserve"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", të ligjitNr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë " , në udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012 të Ministrisësë Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe aktet ligjore e nën ligjore të tyre ,në VKB nr. 106 datë 21.12.2022 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 " për Bashkinë Kurbin. dhe ne kerkesat drejtuar Kryetares se bashkise nga Drejtoria e Arsimit Kultures Rinise dhe Sporteve ,pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë,Keshilli Bashkiak:

**VENDOSI:**

1.Dhenien e nje shperblimi financiare (Honorar) per persona me merita dhe kontribute te veçanta per vendin ,per interest kombetare per shoqerine dhe komunitetin si me poshte:

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Boris Sander FRROKAJ | 100.000 | Per rezultatetelarta ne Sportin e Mundjes |
| 2 | Eklent Alfred KAÇI | 100.000 | Per rezultatetelarta ne Bilardo |
| | Shuma | 200.000 | |

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

**>Prefekti i Qarkut Lezhë**

**>Drejtoria e Financave**

**>Arkivi**

**SEKRETARI I KESHILLIT**

**Arber LEKA**

**KRYETARE E KESHILLIT**

**Edlira LLESHI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA KURBIN

Adresa: Laç ... Tel 0532 22 270 Fax 0535 53 222 225 E-mail: ... yahoo.com

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA KURBIN**
**KESHILLI BASHKIAK**

**Nr 1272 prot**

**Laç më 01 / 03 2023**

# VENDIM

**Nr 15 Datë 24/ 02 /2023**

## "PËR MBARIM MANDATI KESHILLTARI PËRPARA AFATI".

Bazuar në pikën 1,2,3 dhe piken 4 germa b) të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore".Mandati i keshilltarit jepet me vendim këshilli.Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të antareve të këshillit.Mandati i keshilltarit mbaron përpara afatit me dhënien e dorheqjes.Referuar dhe në deklaraten noterjale datë 02.02.2023 ku zj Floralba Ndoj deklaron heqjen dore nga mandati i Anetares së Këshillit Bashkiak si përfaqësuese e partisë socialiste me numer 10 (dhjetë) në listën e fituesve të keshilltareve te partise socialiste Kurbin. Mbeshtetur në vendimin nr 79 datë 26.07.2019 nga Gjykata Apelit Tirane Kolegji Zgjedhor ku partia socialiste Kurbin perfaqesohet në keshillë me 17 mandate.Me shqyrtimin e propozimin nga komisioni i mandateve, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI;**

1. Miratimin e dorheqjes nga mandati i këshillit **zj.Floralba Ernest Ndoj** përfaqësuese e partisë socialiste Kurbin me numer 10(dhjetë) në listën shume emerore të Partisë Socialiste Kurbin në Keshillin Bashkiak.

.Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak.
.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**>Prefektit Të Qarkut Lezhë**
**>KQZ**
**>Arkivi**

**SEKRETARI I KESHILLIT**
**Arber LEKA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KURBIN

**KRYETARE E KESHILLIT**
**Edlira LLESHI**